



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 21

Tiranë – E premte, 12 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 2 datë 4.2.2016	Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve, nga granti 1, “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016.....	2175
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 3 , datë 4.2.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpërndarjen e fondit për programin Shqipëria dixhitale, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”.....	2180
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 4, datë 4.2.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin e infrastrukturës vendore dhe rajonale, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 19.11.2014, nr. 5, datë 9.2.2015, dhe nr. 22, datë 8.5.2015”.....	2182
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 5, datë 4.2.2016	Për shpërndarjen e financimit për disa projekte të grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016.....	2183
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 6, datë 4.2.2016	Për shpërndarjen e financimit për një projekt të programit të shëndetësisë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016	2186
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 7, datë 4.2.2016	Për përcaktimin e përfaqësuesit të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve në bordin e përbashkët të menaxhimit të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal.....	2187





**Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE
VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE**

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
22 shkurt 2016 (afat për projektet e pikës 1.2/a)	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 .
14 Mars 2016 (afat për projektet e pikës 1.2/b)	Aplikuesit sipas pikës 3 të këtij vendimi, si më sipër.	Ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave, nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por vetëm njoftimi i aplikimit.
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
5 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i impaktit dhe përputhshmërisë me politikën kombëtare për zhvillimin lokal e rajonal, sipas pikës B, shtojca III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

- Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik, ligjor (administrativ, dokumentacioni) dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik, ligjor (administrativ, dokumentacioni), dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik përkatës, i ngritur pranë ministrisë së linjës, sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe shtojcës 1 të këtij vendimi.
- Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në pikën A, të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.
- Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B, të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

**Shtojcë II:****FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET****Ky format plotësohet për të gjitha projektet**

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e Financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Shtrirja hapësinore e projektit ☐ Lokal ☐ Ndërlokal ☐ Rajonal ☐ Ndër-rajonal	Në rastet kur aplikuesi është bashki shtrirja e projektit mund të jetë lokale ose ndërlokale kur projekti shtrihet në më shumë se një bashki. Në rastet kur aplikuesi është agjensi zhvillimi rajonal, shtrirja hapësinore do të jetë rajonale ose ndër-rajonale kur projektet i tejkalojnë kufijtë e rajonit aplikues. Për aplikimet, për projektet e shkronjës “b”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të bashkëngjisin në aplikim, edhe marrëveshjen e partneritetit të lidhur midis 2 apo më shumë bashkive. Për aplikimet, për projektet e shkronjës “b”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, agjencitë aplikuese duhet të bashkëngjisin në aplikim, edhe marrëveshjen e partneritetit të lidhur midis tyre dhe 2 apo më shumë bashkive.
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbytur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve të reja (sistem ngrohjeje, mur rrethues etj.) në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nqs parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), kush e mbulon koston e shpronësimit, si edhe dokumentacioni përkatës.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërrhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e



	kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; Nëse po, specifikoni sa është vlera e parashikuar, si do të sigurohet kostoja e parashikuar, etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve
Dokumentet e miratimit të projektit nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti paraqet: - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, me vendim të Këshillit të Qarkut/Bashkisë; - Është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - Vendim të bordit kolegjial drejtues (në rast se është agjenci zhvillimi). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëngjitet një kopje e vendimit/dokumente të tjera.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti
Dokumentet teknike, etj. (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban:



	- projektin teknik/projektin e zbatimit - preventivin - argumentimin teknik - përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshem pervec programit Shqiperia Dixhitale	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- a) Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi online për FZHR (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

Ose

- b) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban vetëm njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës, si dhe listën e projekteve të aplikuar. Lisat e projekteve të aplikuar duhet të jetë sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave, **nuk dorëzohen dosjet e aplikimit**, por vetëm njoftimi i aplikimit.

Shtojca III:

KRITERET E VLERËSIMIT TË

PROJEKTEVE (Shtylla 1 e financimit: zhvillimi vendor dhe rajonal)

A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë**. Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë përkatëse, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015. Këto kriteret konsistojnë në standardet teknike të domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projektzbatimi.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe

qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

3. Ndikimi i projektit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, cilësinë e jetës, shëndetin, dhe zhvillimin ekonomiko-social, në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimin e zhvillimin e aftësive, që vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**, duke plotësuar dy prej komponentëve, si më poshtë vijon:

3.1 Për projektet e pikës 1.2/a, që:

a) prekin qendër qarkun dhe/ose qendër urbane, dhe ndikon në zhvillimin e ekonomive lokale, konsolidimin e strukturës ekonomike të



zonave apo poliqendrave të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin **0 deri 5 pikë**.

b) ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja socio-ekonomike, turistike dhe me potenciale për zhvillimin e ekonomive lokale dhe zonave të përmirësuara të biznesit. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

c) rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

d) ndikon në rehabilitimin mjedisor të zonave të degraduara, parqe urbane dhe krijimin e korridoreve të gjelbër ndërqytetas. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

3.2 Për projektet e pikës 1.2/b, që:

a) prekin më shumë se 2 ose 3 njësi të qeverisjes vendore, dhe/ose rajone dhe ndikojnë në konsolidimin e ndërveprimit socio-ekonomik të njësive dhe/ose zonave të zhvillimit, përmes marrëveshjeve të partneritetit, Për këtë komponent vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht 10 pikë**;

b) përmirësojnë aksesit dhe infrastrukturën e ndërveprimit ekonomik, në nivel ndërvendor, rajonal e ndërrajonal etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**;

c) adresojnë një nevojë të zhvillimit socio-ekonomik rajonal, në funksion të rivitalizimit e qendrave rajonale dhe fuqizimit të rajoneve dhe/ose zonave të zhvillimit. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

4. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të përfituesve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

5. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i fizibilitetit, analiza kosto-përfitim etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga **0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që

lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

7. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

B. Kriteret e vlerësimit të impaktit dhe përputhshmërisë

Këto kritere përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e impaktit dhe përputhshmërisë së projektit, me politikën kombëtare për zhvillimin rajonal, duke vlerësuar një projekt me, **maksimalisht, 30 pikë**, si më poshtë vijon.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e impaktit të projektit në krijimin e vendeve të reja të punës dhe vlerës së shtuar nga investimi, si dhe mundësinë për tërheqjen e investimeve të reja. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë**.

2. Përputhshmëria me politikën kombëtare të zhvillimit rajonal, dhe objektivat e kohezionit territorial e rritjes së konkurrueshmërisë së rajoneve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë**.

VENDIM

Nr. 3 , datë 4.2.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 16.10.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN SHQIPËRIA DIXHITALE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin Shqipëria dixhitale, pjesë e Fondit për



Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për t’u komunikuar vendimin Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Ministrisë së Financave.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr. 4, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi, i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me ZRPP-në	Përditësimi dhe përmirësimi i të dhënave në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë	370,826,820	74,165,364	296,661,456

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6926/2 prot., datë 2.12.2015, dhe me kërkesë të sekretariatit teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5280/2 prot., datë 5.1.2016. Financimi i këtij projekti do të kryhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Pika 5, në shënimet e tabelës 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.

3. Totali i vlerës së projektit, si dhe vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
	TOTALI		536,902,131	147,308,853	389,593,278

4. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi ndryshon: nga 5 projekte bëhet 4 projekte.

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



VENDIM
Nr. 4, datë 4.2.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 39, DATË 16.10.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE NR. 18, DATË 19.11.2014, NR. 5, DATË 9.2.2015, DHE NR. 22, DATË 8.5.2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin e infrastrukturës vendore dhe rajonale, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 19.11.2014, nr. 5, datë 9.2.2015, dhe

nr. 22, datë 8.5.2015”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projekti nr. 3, në tabelën 1 të këtij vendimi, ndryshon, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU ELBASAN					
3	Bashkia Elbasan	Sistemim - asfaltim i rrugëve “Sul Misiri” dhe “Fehmi Kotherja”	73,933,175	16,473,074	57,460,101
4	Bashkia Elbasan	Sistemim - asfaltim i rrugës “25 Nëntori”	90,797,561	16,473,074	74,324,488

Shënim

Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi, ndryshon: nga 31 projekte bëhet 32 projekte. Rinumërimi i projekteve fillon tek projekti 4, deri në numrin rendor nr. 32.

**VENDIM****Nr. 5, datë 4.2.2016**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR DISA PROJEKTE TË GRANTIT TË
ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I,
PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2015–2016 , për grantin e arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri

Ministri i Financave

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,

Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ministri i Zhvillimit Urban

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

Ministri i Arsimit dhe Sportit

Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe

Administrimit të Ujërave

Ministri i Shëndetësisë

Ministri i Kulturës

Ministri i Mjedisit

Ministri i Punëve të Brendshme

Ministri i Shtetit për Inovacionin

dhe Administratën Publike

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë

Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar
anëtar;

anëtar

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar.



Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e Projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (Lekë)
QARKU FIER							
1	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion i kopshtit dhe palestres, në shkollën "Koli Sako", Bashkia Divjakë	59,941,649	42,591,146	29,970,825	12,620,321	0
2	Bashkia Divjakë	Ndërtim i palestres, terreneve sportive, rikualifikimi i hytjes, ana perëndimore dhe muri rrethues i shkollës së mesme "Miti Zoi Zaka", Bashkia Divjakë	67,144,140	63,580,018	33,572,070	30,007,948	0
3	Bashkia Lushnjë	Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme "18 Tetori", Bashkia Lushnje	53,141,487	51,527,960	14,570,744	36,957,216	0
QARKU KORÇË							
4	Bashkia Korçë	Terrenet sportive, shkolle "Qendër komunitare"	10,973,517	10,832,227	5,999,217	4,833,010	0
QARKU VLORË							
5	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Vlorë	60,789,733	60,634,039	59,804,039	830,000	0
6	Bashkia Sarandë	EKO Kampus Saranda	347,771,215	330,577,453	-	165,288,727	165,288,727
QARKU DURRËS							
7	Bashkia Durrës	Ndërtim i shkollës "Bajram Curni", Durrës	119,376,062	96,564,458	29,980,000	33,292,229	33,292,229
8	Bashkia Krujë	Ndërtim i palestres së shkollës 9 vjeçare nr.4	31,318,083	31,296,264	8,856,329	22,439,935	
QARKU TIRANË							
9	Universiteti i Arteve Tiranë	Rikonstruksion i sallës së lëvizjes skenike dhe pajisja me mjete e pajisje mësimore, mbështetëse	30,388,176	28,729,591	10,126,000	18,603,591	0
QARKU BERAT							
10	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksion i kopshtit qendër Ura Vajgurore	26,705,933	24,906,951	24,254,944	652,007	0
AGJENCI ZHVILLIMI							
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, fshati Sheq Musalalaj, komuna Frakull	32,543,699	19,212,736	16,271,850	2,940,886	0
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Dersnik, komuna Voskop	12,173,171	8,180,487	6,086,586	2,093,901	0
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Supervizion dhe kolaudim për ndërtimin e objekteve arsimore	7,751,358	7,751,388	996,917	3,976,233	0
Totali			860,018,223	776,384,718	240,489,521	334,536,004	198,580,956

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe shërben si referencë për përllogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2015.



2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, dhe korrekton vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
3. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
4. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.
5. "Vlera e financimit", për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së realizuar për vitin 2015 dhe vlerës së financimit për vitin 2016.

Tabela 2. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, për të cilët është përmbyllur shlyerja e detyrimeve, përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e Financimit për vitin 2016 (Lekë)	Shënim (sekretariati teknik MAS)
1	Bashkia Krujë	Rikonstruksioni i shkolles se mesme "Skenderbej" Krujë, (sistem ngrohje, sisteme te jashtme, terrene)	25,501,820	25,501,820	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
2	Bashkia Cërrik	Rikonstruksion dhe ndertim palestres I shkolles 9-vjecare "7 Marsi" Bashkia Cërrik	51,300,000	51,300,000	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
3	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i palestres se gjimnazit Shefqet Buzi, Bashkia Gramsh	3,000,000	3,000,000	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
4	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkolles se mesme "Janaq Kilica", Bashkia Fier	27,165,114	27,165,114	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
5	Bashkia Korçë	Shtese shkolla 9-vjecare "Stavri Themeli", Bashkia Korce	43,113,677	43,113,677	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
6	Bashkia Laç	Rikonstruksion i kopeshtit nr.1 ne Bashkine Lac (dykate)	40,440,138	40,440,138	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
7	Bashkia Lezhë	Rikonstruksioni i salles se qendres kulturore femijeve	6,436,086	6,436,086	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
8	Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Xheladin Fishta"	14,586,532	14,586,532	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
9	Bashkia Kavajë	Ndertimi i kopshtit ne lagjen nr.2 tek ishrezervat e shtetit, Kavaje	20,692,401	20,692,401	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
10	Fondi Shqiptar i	Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare Fshati Toshkëz,	25,637,395	25,637,395	0	Përmbyllur shlyerja e



	Zhvillimit	Komuna Allkaj , Lushnjë				detyrimit
11	Bashkia Ura Vajgurore	Sistemim, rrethim oborri, ndertim palestre shkolla e bashkuar, lagjia "4 Shtatori" Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore	24,317,111	24,317,111	0	Përmbyllur shlyerja e detyrimit
Totali			282,190,274	282,190,274	0	

Tabela 2. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, të cilat janë në proces prokurimi

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Emertimi i projektit	Vlera e Projektit (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e Financimit për vitin 2016 (Lekë)	Shënim (sekretariati teknik MAS)
1	Bashkia Tiranë	Liceu Artistik "Jordan Misja", Tiranë	84,746,629	0	84,746,629	Në proces prokurimi
2	Bashkia Tiranë	Rikualifikim I terrenit sportive në shkollën "Petro Nini Luarasi"	25,000,000	0	25,000,000	Në proces prokurimi
Totali			368,708,096	0	109,746,629	

VENDIM

Nr. 6, datë 4.2.2016

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR NJË PROJEKT TË PROGRAMIT TË SHËNDETËSISË, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për një projekt në vazhdim, me cikël financimi 2014–2015, për programin e shëndetësisë, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar
anëtar;

anëtar
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar.



Tabela 1. Projektet në vazhdim, në programin e Shëndetësisë, me cikël financimi 2014–2015

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e realizuar për vitin 2015 (lekë)	Vlera shtesë e realizuar për vitin 2015 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë)
Qarku Lushnjë						
1	Bashkia Divjakë	Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore, Divjakë	46,965,000	22,600,000	9,365,000	15,000,000
		Totali	46,965,000	22,600,000	9,365,000	15,000,000

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

2. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

3. “Vlera shtesë e realizuar për vitin 2015” tregon vlerën e financimit, shtesë të alokuar për vitin 2015, nga 2 aktet normative të ligjit për buxhetin, për vitin 2015. Vlera e shtesë, e realizuar përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

4. “Vlera e financimit për vitin 2016”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së realizuar dhe vlerës shtesë së realizuar, për vitin 2015.

VENDIM

Nr. 7, datë 4.2.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E
PËRFAQËSUESIT TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE NË
BORDIN E PËRBASHKËT TË
MENAXHIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN
RAJONAL DHE AGJENCISË PËR
ZHVILLIM EKONOMIK RAJONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 3, të vendimit nr. 961, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Zëvendëskryetari i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, z. Niko Peleshi, të jetë përfaqësues i këtij Komiteti në Bordin e Përbashkët për Zhvillim të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal.

2. Ngarkohet Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për t'u komunikuar vendimin Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë